



LAJME nga FONDACIONI
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË
Tiranë

N.22
Nëntor
2025

Redaksia "ZKM ALBANIA"
Kompleksi Spitalor Universitar
"Zoja e Këshillit të Mirë"
Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë

unikzkm
unikzkm
www.unizkm.al
pr@fzkm.org

NIS NJË PROCES ENTUZIASMUES

Njihuni me kandidatët
e Të Drejtës për vitin 2026

Po nisim përgatitjet për zgjedhjen e Të Drejtës të vitit 2026 që do të kulmojë në Janar me procesin e votimit në kampusin tonë ZKM. Kemi përzgjedhur 5 profile njerëzore dhe frymëzuese që besojmë se do të tregojnë më së miri triumfin e betejave për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe planetin tonë nga rreziqet e shumta. Po publikojmë në këtë buletin biografitë e njerëzve që përmbushin sipas nesh karakteristikat që duhet të ketë I Drejti, një titull nderues për ata që nuk jetojnë më, por që kanë lënë pas jehonën e një jete plot pasion, punë, përkushtim, besim dhe bashkëveprim me të gjithë ata që kanë patur nevojë. Ata janë **Falcone e Borsellino, Annalena Tonelli, Ken Saro Wiwa, Anna Politkovskaja, Frere Roger Schutz**. Pesë profilet që propozojmë vijnë nga fusha të ndryshme të jetës dhe angazhimit. Ata i bashkon edhe pse nuk njiheshin me njëri-tjetrin dhe jetuan në kohë të ndryshme pasioni dhe dashuria për drejtësinë, për të vërtetën, për njerëzit e pamundur dhe për mbrojtjen e mjedisit e natyrës. Votimi për zgjedhjen e Të Drejtës 2026 do të jetë i fshehtë dhe si çdo vit do të organizohet në Kampusin tonë, në Spitalin Katolik, në Poliambulancën At'Luigji Monti dhe në Universitetin Katolik. Kjo iniciativë që erdhi në Shqipëri për herë të parë nga Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë mori shkas



**KOPSHTI
I TË DREJTËVE** Tiranë, Shqipëri

nga vendimi i Parlamentit Evropian që 6 marsin e çdo viti e ka shpallur si dita e Të Drejtës, e grave dhe burrave që jetuan për komunitetet e tyre lokale duke sakrifikuar edhe jetën. Njihuni më poshtë me biografitë e tyre.


NJË HAPËSIRË REFLEKTIMI

Kopshtet e të Drejtëve janë krijuar për të nderuar gratë dhe burrat, të cilët përballë mizorive masive marrin përgjegjësi personale për të mbrojtur dinjitetin njerëzor dhe për t'u ardhur në ndihmë viktimave. Këto hapësira kanë si qëllim t'u paraqesin si shembull opinionit publik ata njerëz që edhe duke rrezikuar jetën kanë qenë të aftë të shkojnë kundër rrymës dhe të ruajnë vlerat njerëzore përballë ligjeve të padrejta apo indiferencës së shoqërisë. Një I Drejtë vepron sepse dëgjon thirrjen e ndërgjegjes së tij, i do të tjerët dhe bukurinë e jetës. Për të festuar njëzet vjetorin e themelimit të Universitetit ZKM në vitin 2024 u inaugurua në Tiranë Kopshti i të

Drejtëve, i vetmi në Shqipëri i kësaj natyre. Ai karakterizohet nga gdhendja e emrave të të Drejtëve në gurë të marrë nga zona të ndryshme të vendit duke simbolizuar forcën shembullore dhe bukurinë e përhershme të dëshmisë së tyre. Me këtë nismë Fondacioni ZKM synon të promovojë tek studentët, punonjësit



dhe vizitorët dimensionin shpirtëror të jetës, qytetarinë aktive dhe ndjeshmërinë ndaj së mirës së përbashkët. Kopshti i të Drejtëve është një vend shpirtëror, një hapësirë takimi dhe kujdesi për marrëdhëniet njerëzore.



PËRSE TË VOTOJMË?



L'espressione di un voto esprime il proprio mondo di valori e di convinzioni. Attraverso un voto manifestiamo pubblicamente di sentirci responsabili della comunità in cui viviamo, fino ad abbracciare il mondo intero.

Nella votazione del Giardino dei Giusti ci confrontiamo con storie di vita buona: non si tratta di bocciare o promuovere qualcuno, piuttosto di riconoscere che il bene è diffuso, che molte storie non le conosciamo, che ciascuno di noi può ispirarsi ad un Giusto da seguire. Per questi motivi tu, noi, possiamo votare e costruire cammini.

KUSH DO TË JETË I DREJTI I RADHËS ZBULO KANDIDATËT DHE BËJ QË ZËRI YT TË DËGJOHET!

Falcone dhe Borsellino luftuan me përkushtim sublim realitetin e egër të mafies, realitetin e egër të Cosa Nostra-s që shtrihej me krimet dhe ndikimin e saj deri tek lidhjet me politikën, ekonominë apo grupimet e fshehta subversive. Për shkak të kësaj lufte pa kompromis ata u vranë! Giovanni Falcone lindi në Palermo në vitin 1939. Paolo Borsellino lindi në të njëjtën lagje tetë muaj më vonë, në vitin 1940. Që kur ishin fëmijë luanin futboll së bashku në oborrin e kishës, ndërsa kur u rritën zgjodhën të njëjtin profesion, atë të gjyqtarit, në shërbim të Republikës, jo të një partie. Edhe pse ishin me bindje politike të kundërta Paolo i dhathtë ndërsa Giovanni i majtë, ata ndanë të njëjtin pasion për punën. Rugët e tyre u kryqëzuan pas fëmijërisë në fund të viteve '80 kur u thirrën në grupin e parë antimafia duke arritur rezultate të jashtëzakonshme. Ngritën me profesionalizëm një proces gjyqësor me 474 të pandehur madje në burg përfunduan edhe politikanë të fuqishëm sicilianë të kohës. Por grupi nuk i mbijetoi pengesave kritike. Falcone u sabotua, u braktis nga kolegët derisa u eliminua fizikisht më 23 maj 1992 në një atentat brutal në autostradë. Borsellino e ndjente se vdekjen e kishte afër. I rrëfeu gruas së tij se ekzistonte një marrëveshje midis mafies dhe njerëzve jo besnikë



FALCONE DHE BORSELLINO

.....
Jo mafias!

ndaj shtetit. Edhe ai u eliminua më 19 korrik të po atoj viti. Sot kujtohet edhe shprehja e Falcones: "Vdesim sepse jemi të vetëm ose sepse kemi hyrë në një lojë shumë të madhe... sepse na mungon mbështetja.

"Ata lanë pas një Itali me më shumë të vërteta mbi të keqen e saj më të madhe, ndërsa sot nderojmë jetët e tyre që bëhen thirrje për të gjithë ata që e duan vendin e tyre të lirë nga mafia.

2



ANNALENA TONELLI

Ajo që ka rëndësi është dashuria

Prania e kësaj gruaje mes popullsisë myslimane në shkretëtirën e Kenias i mahniti të gjithë. Nuk ishte e martuar dhe nuk i përkiste asnjë urdhri fetar. Annalena mbërriti në vitin 1970 në Ejajir në kufirin me Somalinë mes nomadëve dhe qëndroi atje deri në vitin 1985. Mëndihmën e shtetit dhe të miqve krijoi një qendër për personat me aftësi të kufizuara dhe për të sëmurët me tuberkuloz. Ishin

njerëz jashtëzakonisht të varfër, të braktisur. Ajo studioi sëmundjet dhe u specializua ndonëse ishte e diplomuar më parë për drejtësi. Annalena lindi në Forlì (Itali) në vitin 1943 ishte një vajzë e angazhuar në shoqatat katolike dhe që herët fliste për një ëndërr: të shpallte Ungjillin duke jetuar mes më të varfërve dhe në një botë myslimane njëkohësisht, por duke praktikuar shërbesë në heshtje dhe pa predikim të imponuar. Në vitin 1984 denoncoi një masakër dhe një vit më pas u dëbua nga vendi sepse konsiderohej "e padëshiruar". Shkoi në Somali gjatë viteve të trazirave dhe luftës civile madje u përball edhe me rrëmbimin. Konflikti e detyroi të shpërngulet në Somaliland ku qëndroi pranë atyre që vuanin, përballë armiqësive gjithnjë e në rritje nga ekstremistët për një periudhë shtatë vjeçare. Më 5 shtator 2003 u vra nga dy atentatorë vetëm pak pasi kishte kryer vizitën tek të sëmurët. Dy vite para vrasjes ajo kishte thënë: "Jeta ime ka njohur rreziqe të shumta, kam qenë shumë herë pranë vdekjes... E kam përjetuar në mish e në shpirt ligësinë e njeriut, perversitetin dhe mizorinë e tij... Dhe nga kjo kam dalë me bindjen e palëkundur se e vetmja gjë që ka rëndësi është dashuria". Jeta e saj është një shembull dashurie pa kufij.

Ken Saro-Wiwa ishte romancier, poet dhe producent televiziv shumë i njohur me kombësi nigeriane. Ai udhëhoqi një lëvizje paqësore në mbrojtje të të drejtave të pakicës Ogoni që numëronte rreth gjysmë milioni njerëz pranë deltës së Nigerit që shfrytëzohej nga kompania shumëkombëshe e naftës Shell. Regjimi ushtarak e burgosi disa herë dhe pas shumë përplasjesh me sistemin u dënua me vdekje nga një gjykatë që ngrii një proces të nxituar dhe farsë. Pavarësisht protestave ndërkombëtare Saro-Wiwa u var më 10 nëntor 1995 së bashku me tetë aktivistë të tjerë, ishte vetëm 54 vjeç. Romancierin nuk e lejuan të lexonte deklaratën e tij, e cila më vonë u publikua dhe tashmë njihet nga publiku. Ken Saro-Wiwa shkruante: "Unë jam njeri i paqes, i ideve, por jam i tmerruar nga varfëria poshtëruese e popullit tim edhe pse jeton në një tokë të pasur. Jam i dëshpëruar për përjashtimin politik të njerëzve dhe për varfërimin ekonomik të cilit i nënshtrohen, jam i indinjuar për shkatërrimin e territorit të vendit që është pasuria jonë themelore, por jam i vendosur të mbroj të drejtën jo vetëm për të jetuar, por edhe për një jetë të denjë. Kam investuar burimet e mia intelektuale dhe materiale

3



KEN SARO WIWA

*Për tokën e tij,
popullin e tij
dhe mjedisin*

gjithë jetën time në një kauzë ku besoj verbërisht dhe për të cilën nuk mund pranoj shantazhe apo kërcënime... Nuk kam asnjë dyshim se në fund kauza ime do të fitojë pavarësisht sa sprova dhe mundime do të has gjatë rrugës unë dhe ata që besojnë me mua në këtë kauzë. As burg, as vdekja nuk mund ta ndalin fitoren tonë përfundimtare. Të gjithë ne jemi përballë historisë. E përsëris: jemi të gjithë përballë historisë". Jeta e tij na mëson të mbrojmë atdheun, tokën tonë, mjedisin dhe popullin nga shfrytëzimi.

4



ANNA POLITKOVSKAJA

E vërteta do t'ju çlirojë

Aнна Политковская ishte e pamëshirshme ndaj të fuqishmëve të vegjël apo të mëdhenj duke nisur nga Putin. Por ajo ishte plot dhembshuri njerëzore për viktimat, të pafajshmit e shtypur, të torturuar, të zhdukur, të vrarëap të harruar. Një grua e madhe dhe simbol i gazetarisë së lirë që dinte të thoshte të vërtetat që e lëndonin pushtetin politik dhe që shumë qytetarëve nuk u pëlqente ti dëgjonin. Anna lindi në vitin 1958 në Neë York nga prindër ukrainas, ish-diplomatë sovjetikë dhe u kthye në Rusi ku u diplomua për gazetari. Shkroi për "Novaja Gazeta", gazetë e drejtuar nga Dmitrij Muratov (Çmimi Nobel për Paqen 2021). Ndoqi luftërat në Çeçeni dhe tragjeditë e tjera në Kaukazin rus. Hetimet e saj përfshinë terrorizmin islamik dhe represionin ushtarak, sulmet e frikshme dhe bombardimet mizore. Ajo vizitoi fshatra, spitale, kampe refugjatësh, Anna fliste me njerëzit, përshkruante vuajtjet e padëgjjuara të popullsisë civile.

Shkroi për marrëveshje të pista të naftës, për shkakun e vërtetë të luftës, për torturat dhe eliminimet e të pafajshmëve dhe aktivistëve të të drejtave të njeriut. Më 7 tetor 2006 ndërsa po merrte ashensorin në banesën e saj në qendër të Moskës u vra nga një person i panjohur me pesë plumba pistolette. Anna kishte shkruar: “Por në fund të fundit çfarë do të kisha bërë! Shkrova atë që pashë! Dhe kaq! I injoroj ‘gëzimet’ e tjera të rrugës që kam zgjedhur si helmin në çaj, apo arrestimin apo letrat kërcënuese. Kërcënime përmes internetit... E rëndësishme është të kesh mundësinë të bësh diçka të dobishme”.

Jeta e saj na mëson se për të vërtetën mund të jesh i pamëshirshëm me të fuqishmit dhe i butë me të dobët.



FRÈRE ROGER SCHUTZ

*Shpirti
që na bën
vëllezër*

Frère Roger, kalvinist zviceran dhe student i teologjisë u largua nga vendi i tij në vitin 1940 kur ishte 25 vjeç dhe zgjodhi të jetonte në Taizé, një fshat i vogël në Burgundy të Francës ku promovoi nisma për të ndihmuar dhe ofruar mikpritje për refugjatët dhe të përndjekurit. Pas disa vitesh themeloi një komunitet të krishterë ndërfetar monastic, i cili ishte ndërkombëtar në qasje, një bashkësi paqeje dhe shërimi nga përçarjet midis besimtarëve të krishterë dhe jo vetëm.

Që nga viti 1968 në periudhën e ndryshimeve të trazuara dhe rrënjësore në shoqërinë botërore mikpritja dhe

hapja ekumenike e bashkësisë që krijoi, u mundësoi shumë të rinjve t'i qasen dialogut konstruktiv dhe pajtimit. Lutja ndërfetare e komunitetit të Taizé-s ka prekur breza besimtarësh me këngën e saj origjinale fetare që të magjeps dhe tërheq. Thjeshtësia e stilit të jetës që propozon komuniteti i vëlla Roxherit u bë një magnet shumë i fuqishëm shpirtëror për ata që kishin nevojë. Që nga vitet '70 e deri sot shumë të rinj duke ndjekur këto përvoja kanë rizbuluar veten dhe kanë transformuar jetën e tyre në mision, secili në fushën e tij. Në oazin shpirtëror të paqes në fshatin Taizé politikanë, shkencëtarë, intelektualë, njerëz të famshëm, njerëz të zakonshëm, udhëtarë të thjeshtë janë lutur, kanë medituar, shkëmbyer mendime dhe kanë marrë vendime për jetën.

Mbrëmjen e së martës më 16 gusht 2005 në moshën 90 vjeçare, vëlla Roxheri u qëllua me thikë për vdekje nga një vajzë me çrregullime gjatë lutjes në kishën e Pajtimit, në praninë e 2,500 të rinjve. Ai mbahet mend si dëshmitar shprese dhe vëllazërie duke hapur rrugë të panumërta si midis të krishterëve ashtu edhe mes të gjithë njerëzve me vullnet të mirë, pavarësisht besimit të tyre.

KULTURË

DANTE I PASHMANGSHËM

Ismail Kadarë

T'i shmangesh Dantes është po aq e pamundur sa t'i shmangesh ndërgjegjjes: ky është “thelbi” i një teksti të shkurtër të **Ismail Kadaresë**, me të cilin shkrimtari i madh shqiptar përshkruante marrëdhënien që mund të ekzistojë midis Shqipërisë dhe Dantes, poetit italian par excellence. Zbulimi i “Komedisë Hyjnore” pas rënies së Perandorisë Osmane shënoi për shqiptarët fillimin e një marrëdhënieje të veçantë të mbushur me mijëra ngjashmëri shprehjesh dhe tematikash. Një marrëdhënie që u lidh në shekullin e njëzetë në mënyrë të pandashme. I imponuar si poet zyrtar nga regjimi pushtues i Musolinit, Dante ruan një vend të rëndësishëm edhe në Shqipërinë komuniste, sistemi i tmerrshëm i burgjeve të së cilës i ngjante shumë Ferrit të Dantes. Duke rikujtuar fazat themelore të historisë së vendit të tij Kadare tregon se si Dante ka qenë “në mënyrë të pashmangshme” i pranishëm në çdo moment duke ofruar me artin e tij një burim të pashtershëm bukurie dhe strehë nga tmerret e historisë. Libri është i disponueshëm në Bibliotekën Universitare “Fratel Paolo Ruatti”.





Një kremtim sa shpirtëror dhe njerëzor u mbajt në Kampusin UKZKM gjatë nëntorit. Komuniteti ynë universitar u mbledh në lutje për të festuar Ditën e Martirëve Shqiptarë. Eukaristia e udhëhequr nga Arqipeshkvi Monsinjur Arjan Dodaj ishte një moment besimi, kujtimi dhe ripërtëritjeje të thellë në Shpirt.

Gjatë kremtimit disa studentë nga universiteti UNIZKM morën Sakramentin e Konfirmimit, një shenjë hiri dhe pranie të gjallë të Shpirtit të Shenjtë midis nesh. Dëshmia e Martirëve Shqiptarë le të vazhdojë të na frymëzojë të jetojmë besimin tonë me guxim, dashuri dhe gëzim.

HISTORI

NJË "LEGJENDË E GJALLË" E FTUAR NË UNIZKM

Dyanne Affonso



(në foto: Dyanne në Kopshtin tonë të Drejtëve)

Jemi të lumtur dhe krenarë që festojmë çmimin prestigjioz "Living Legend" që i është dhënë profesoreshës Dyanne Affonso nga American Academy of Nursing (AAN). Ky nderim, më i larti që mund të japë AAN i kushtohet udhëheqësve të infermierisë puna e të cilëve ka pasur një ndikim transformues dhe të qëndrueshëm mbi shëndetin dhe profesionin në nivel global. Profesoresha Affonso u nderua për punën e saj të jashtëzakonshme pioniere duke lënë një gjurmë të pashlyeshme në zhvillimin e politikave shëndetësore dhe në kërkimin shkencor infermieristik.

Angazhimi i saj veçanërisht mbi shëndetin e grave dhe menaxhimin e stresit maternal-fetal ka ndihmuar në përcaktimin e standardeve dhe udhëzimeve ndërkombëtare. Universiteti "Zoja e Këshillit të Mirë" (UNIZKM) ka pasur privilegjin e madh të mirëpresë atë si të ftuar nderi në rastin e Konferencës së fundit ndërkombëtare të organizuar nga Qendra jonë për Kërkimet Infermieristike Montianum (CIRIM). Si dëshmi e mëtejshme e kësaj lidhjeje të thellë Prof. Gennaro Rocco, Drejtori i CIRIM mori pjesë në ceremoninë solemne të marrjes së detyrës që u zhvillua në Uashington më datë 17 tetor të këtij viti.

I gjithë komuniteti akademik i UNIZKM i shpreh urimet më të singerta Dyanne për këtë arritje të merituar dhe historike

NJË VIT I RI PLOT SFIDA DHE ENTUZIASËM

Uruam këtë muaj mirëseardhjen dhjetra të rinjve që tashmë janë studentë të Odontoiatrisë në Programin e Studimit Odontoiatri dhe Proteza Dentare pranë Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë". Studentët tanë të vitit të parë akademik u mikpritën në një audiencë të posaçme nga Presidenti i Fondacionit ZKM **fr. Ruggero Valentini**, Dekania e nderuar e Mjekësisë në UKZKM **Prof. Anila Godo**, Koordinatorja **PhD. Prunela Poliçi** dhe **Prof. Vincenzo Campanella**. Duke ju uruar një vit të mbarë studentor Presidenti i Fondacionit Fr. Ruggero dhe Dekania Godo përgëzuan studentët që zgjedhën Odontoiatrinë në Universitetin Katolik, i cili ofron praktikat mësimore më të përparuara në Shqipëri dhe të vlefshme njësoj si në vendet e Bashkimit Evropian.

Fr. Ruggero Valentini tha se vitet e studimit në universitet do të ndihmojnë të rinjtë të formojnë profilin e tyre njerëzor dhe do t'u japin mundësi të studiojnë në një



kampus modern, multikulturor dhe sportiv që është ndërtuar posaçërisht për të qenë djepi i edukimit të brezave të rinj.

Mes emocioneve Prof. Campanella ftoi studentët ta jetojnë me pasion dhe përkushtim kohën e universitetit duke ndarë me ta në disa momente emocionale edhe mallëngjimin personal sepse ai ka pritur në këtë kampus dhe ka ëprcjellë dhjetra të rinj që sot kanë fituar karriera të suksesshme falë studimit në UKZKM.

Duke ju uruar rrugëtim të mbarë në UKZKM përgëzojmë studentët tanë dhe familjet e tyre që besuan në cilësitë dhe standardet evropiane të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë".


ZKM, KONFERENCË NË BRAZIL

Nga data 23 deri më 25 tetor u zhvillua në Rio de Janeiro Konferenca Ndërkombëtare e Ortodontisë e organizuar nga World Federation of Orthodontists një ngjarje me rëndësi globale që mbahet çdo pesë vjet dhe mbledh ekspertët më të mëdhenj të fushës. Për herë të parë Shqipëria u përfaqësua në këtë konferencë prestigjioze falë pjesëmarrjes si relatore të **Dr. Françeska Vinjoli** përgjegjëse e Klinikës Stomatologjike ZKM në Tiranë.

Në cilësinë e pedagoges së Ortodontisë dhe anëtare e Departamentit të Shkencave Mjekësore ajo prezantoi një punim me titull: **"Trajtimi funksional i malokluzionit të Klasës II me retruzion mandibular: roli i kohës (timing) së ndërhyrjes dhe karakteristikave fillestare të pacientëve.**



RAPORTI I VLERËSIMIT TË SHQIPËRISË



CESPIC njoftoi publikimin e Raportit "Shqipëria në Sytë e Botës 2024-2025".

Ky raport vjetor sheh thellë në metrika të ndryshme socio-ekonomike duke sjellë njohuri nga raporte dhe studime profesionale.

Raporti u promovua gjatë një takimi në UKZKM, për të cilin Presidenti i FZKM **fr. Ruggero Valentini** tha se jep një kontribut në njohjen e Shqipërisë në botë në mënyrë profesionale. Ndërsa Drejtori i Qendrës CESPIC **Prof. Raul Caruso** iu drejtua audiences me ftesën për ta shfletuar raportin, si një burim të dhënash profesionale.

Qëllimi i këtij raporti është të përshkruajë statusin e Shqipërisë dhe trajektoren e saj në sfera të ndryshme sociale, ekonomike dhe politike. Mendojeni si udhëzuesin

tuaj për të lundruar në rrugën e zhvillimit të Shqipërisë – një vademekum i mbushur me informacione të vlefshme për studentët, studiuesit, gazetarët, politikëbërësit, sipërmarrësit dhe investitorët! Por kjo nuk është e gjitha! "Shqipëria në Sytë e Botës" përfshin gjithashtu një analizë krahasuese me shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor – Bosnjë dhe Hercegovinën, Maqedoninë e Veriut, Kosovën, Malin e Zi dhe Serbinë të njohura së bashku si Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (WB6).

Nga njëra anë ky krahasim rajonal u mundëson lexuesve të thellohen në karakteristikat socio-ekonomike të Shqipërisë dhe nga ana tjetër ofron një pasqyrë të një rajoni që luan një rol kyç në peizazhin gjeopolitik evropian.

Për më shumë vizitoni linkun: <https://unizkm.al/posts/slug/albania-in-the-eyes-of-the-world>

DREJT ÇMIMIT PËR PAQEN



Prej disa vitesh, Fondacioni ZKM ka themeluar CESPIC (Qendra Europiane e Shkencës për Paqe, Integrim dhe Bashkëpunim) si pjesë integrale e Universitetit "Zoja e Këshillit të Mirë". Inisiativa e fundit e kësaj strukture është Çmimi vjetor i Paqes në bashkëpunim me Observatorin Trans-Europian të Ballkanit dhe Kaukazit.

Për këtë arsye është krijuar një Komision ndërkombëtar i përbërë nga disa anëtarë ex-officio: **Fr. Ruggero Valentini**, President i Fondacionit ZKM; **prof. Leonardo Palombi**, Rector i Universitetit Katolik ZKM; **prof. Raul Caruso**, drejtor

i CESPIC; dhe **dr. Luisa Chiodi**, drejtoreshë e Observatorit Trans-Europian të Ballkanit dhe Kaukazit. Komisioni përbëhet edhe nga anëtarë të tjerë me prejardhje ndërkombëtare: **dr. Senada Šelo-Šabić**, Instituti për Zhvillim dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare me qendër në Zagreb (Kroaci); **prof. Jovan Teokarević**, Universiteti i Beogradit (Serbi); **prof. Alessandra Russo**, School of International Studies – Universiteti i Trentos; **z. Luigj Mila**, Sekretar i Përgjithshëm i Komisionit Justitia et Pax – Albania, i propozuar nga Konferenca Ipeshkvnore e Kishës Katolike të Shqipërisë; **prof. Andi Rembeci**, Universiteti i Tiranës, i propozuar nga Patriarkati Ortodoks i Shqipërisë. Komisioni u mbledh në dy raste për të shqyrtuar kandidaturat e ardhura për **Çmimin e Paqes 2025**, të cilat lidhen me përvoja interesante dhe aktive në disa vende të rajonit të Ballkanit. Në numrin e ardhshëm të ZKM Albania do të jepen informacione më të zgjeruara mbi fituesin dhe ceremoninë e ndarjes së çmimit.



KOLAUDIMI U KRYE

Anxhograf i ri në spital



Spitali Katolik ZKM vijon të fuqizojë në mënyrë të vazhdueshme ofertën shëndetësore në shërbim të shëndetit të qytetarëve. Së fundmi pjesë e korpussit të aparaturave u bë anxhografi i modelit të fundit, teknologji që përfaqëson gur themeli për inovacionin terapeutik. Ky sistem i avancuar krijon mundësi të reja për kujdesin ndaj pacientëve kardiologjikë, onkologjikë dhe me sëmundje vaskulare duke u dhënë mjekëve tanë mjete që shpëtojnë jetën dhe diagnostikojnë me saktësi këto patologji, duke forcuar standardin e diagnostikimit dhe terapisë. Ky investim jo vetëm që rrit standardet e trajtimit kardiologjik, onkologjik dhe vaskular në nivel kombëtar, por integrohet plotësisht edhe në misionin tonë formues. Falë bashkëpunimit të konsoliduar me Fakultetin e Mjekësisë spitali e kthen këtë teknologji të avancuar në një pikë qendrore për praktikat profesionale, për specialistantët duke u ofruar edhe studentëve një pamje të drejtpërdrejtë mbi procedurat që duhen ndjekur për të kontribuar në të njëjtën kohë në formimin e brezit të ri të mjekëve specialistë për vendin. Kjo aparaturë revolucionarizon edhe mësimin në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" duke rritur vlerën e programeve të studimit dhe duke siguruar përditësimin e mësimave në fushën e mjekësisë sipas standardeve evropiane. Pas një periudhe përgatitjesh dhe kontrollesh me instalimin e plotë anxhografi i ri është plotësisht në dispozicion të pacientëve. Ne ju kemi prezantuar në buletinet tona aftësitë e kësaj aparature radiologjike, e cila lejon edhe ndërhyrje të ndërlikuara kirurgjikale pas verifikimeve të imtësishme të kësaj aparature. Testimi u krye në bashkëpunim me kompaninë prodhuese, me Inxhinierin Abundo të Poliklinikës Tor Vergata dhe mjekët e profilizuar.

NJË PROFESION QË DUHET USHTRUAR NË KOMUNITET

Karizma/ Luigji Monti infermier

At Monti jetoi në shekullin e 19-të një shekull transformimi edhe për botën e kujdesit shëndetësor. Në vitin 1857 ai themeloi një komunitet njerëzish të shuguruar nën emrin "Bijtë e Zojës së Papërlyer". Ishte shekulli në të cilin Maria, nëna e Krishtit u shpall "e papërlyer" nga Papa Piu IX pra e lirë nga pushteti i së keqes për të qenë krijesa e denjë që të mbante në barkun e saj Birin e Perëndisë. Shekulli i 19 është shekulli i Ngjizjes së Papërlyer dhe pikërisht me këtë emër Maria i shfaqet Bernardettës në Lurdes ku tani ndodhet një nga shenjtëroret më të njohura të Marisë në botë. Një shenjtërore të sëmurësh par excellence. Ishte një shekull i karakterizuar fuqimisht nga virtyti i krishterë i bamirësisë dhe shumë iniciativa lindën për të ndihmuar burra e gra në vështirësi. Ato ishin në funksion të fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, emigrantëve dhe punëtorëve...

Në këtë peisazh zhvillimesh, Luigji në të tridhjetat e hershme ndjen impulsin për të krijuar një komunitet infermierësh të gjithë të përkushtuar për t'u shërbyer të sëmurëve. Një zgjedhje origjinale e tij pasi ai kërkonte që ky profesion të ushtrohej jo thjesht nga individë, por nga një komunitet i tërë. Ishin vite trazirash. Florence Nightingale e realizoi projektin e saj për të themeluar profesionin e infermierit mbi baza arsimore më rigorozë dhe

më të gjera. Henry Dunant në vitin 1859 ditën pas betejës së Solferinos në Lombardi gjendet përpara "njërës prej pamjeve më të tmerrshme që mund të imagjinohen": një masakër që kishte lënë 40 mijë burra të vdekur dhe të plagosur. Ai vendosi të promovojë Kryqin e Kuq. Si për Nightingale ashtu edhe për Dunant shtysa për të vepruar lind në një kontekst luftarak në të cilin ndodheshin të plagosurit me pak ose aspak kujdes mjekësor. Në ato vite Luigji Monti i paraprirë nga miku i tij Cipriano Pezzini zbret në Romë për të

Ndoshta kemi nevojë për themelues të rinj si Luigji Monti, i cili e përshkruante veten si "një njeri i varfër dhe pa shkollë që i shërbeu Zotit për punët e Tij"

nisur projektin duke nisur nga vendi më i përshtatshëm për iniciativën e tij: Spitali i vjetër "Santo Spirito" në Sassia në bregun e lumit Tevere disa qindra metra larg Bazilikës së Shën Pjetrit. Ai është spitali më i vjetër në Europë i themeluar nga Papët dhe vatër e mjekëve të mëdhenj si dhe e shenjtoreve të mëdhenj. Luigji e kuptoi nevojën për të krijuar një profesion të punonjësve të kujdesit shëndetësor të nivelit të ndërmjetëm, më afër pacientit. Infermierët e asaj kohe ishin kryesisht njerëz me vullnet të mirë, por të pakualifikuar dhe ndonjëherë edhe jo shumë të sjellshëm. Infermierët e At Montit atëherë ishin më të ngjashëm me ata që sot i quajmë "Oss" (operatorë/asistentë social-shëndetësorë). Në fakt ata ushtonin detyra më të thjeshta, por të rëndësishme veçanërisht të përqëndruara në jetën e përditshme

të të sëmurit. Ato përshkruhen sot si pastrimi i korridoreve, zbrazja e enëve, pastrimi i të sëmurëve, ndërrimi i çarçafëve, ushqimi i të sëmurëve rëndë. Në këtë mënyrë u përcaktua edhe të vepruarit: "t'u afroresh të sëmurëve me respekt dhe besim duke njohur tek ata figurën e adhureshme të Krishtit; me përzemërsi, duke treguar gjithmonë një fytyrë të qeshur, me dhembshuri, butësi dhe energji, me paanshmëri dhe kujdes, me dashuri dhe durim. Me interes të vërtetë të pakushtëzuar". Kush e di nëse edhe sot në shekullin e 21-të nuk është i nevojshëm një trajtim njerëzor i profesioneve të kujdesit shëndetësor.

Në foto: Luigji Monti në xhamin e Kapelës së Spitalit Katolik – Tiranë.



VITI I PARË I JETËS NGA TEORIA NË PRAKTIKË

Në fund të muajit tetor në një nga sallat e leksioneve në UKZKM u mbajt seminari me titull “Viti i Parë i Jetës së Fëmijës – Nga Teoria në Praktikë”. Në takim referoi **Prof. Dr. Anila Godo**, Dekane e Fakultetit të Mjekësisë, UKZKM



dhe **Dr. Ilsa Mula**, Peditre në Spitalin Katolik Zoja e Këshillit të Mirë. Seminari ishte një mundësi për mjekët e rinj për të thelluar njohuritë mbi zhvillimin fizik, psikomotor dhe afektiv të fëmijës me realitete praktike.

Gjatë seminarit u shqyrtuan aspekte të rëndësishme si zhvillimi fizik dhe kognitiv i fëmijës, ushqyerja dhe kalimi në ushqimin e rritur, komunikimi para-lingual dhe shenjat e alarmit që duhet të vënë re prindërit e rinj dhe mjekët e rinj peditër.

Seminari u shërbeu të ftuarve të përfitonin nga përvoja e gjerë dhe e gjatë në mjekësi e Prof. Dr. Anila Godo.

VLERËSIM PËR FONDACIONIN ZKM NË SHQIPËRI

Firenze: tek shkolla
e Shën Martin

Salla rilindase e shekullit të XVI në Palazzo Vecchio në Firenze ishte vendi i veçantë i dorëzimit të çmimit “Mburojat e Shën Martin” 2025.

Ky vlerësim tashmë në **edicionin e 42-të** nderon ata që në Itali dhe në mbarë botën dallohen përmes akteve guximtare, solidaritetit dhe përkushtimit ndaj të tjerëve.

Eventi u zhvillua më 8 nëntor duke u hapur me tingujt e trombave të Gonfalonit të Qytetit të Firences. Midis shumë autoriteteve fetare, civile dhe ushtarake ishte i pranishëm edhe një delegacion i Fondacionit ZKM nga Tirana. Në fillim të ceremonisë bëri hyrjen e tij solemne në sallë “modeli” simbolik nga i cili formohen “Mburojat e Shën Martin”.

Gjatë vitit 2024/25, ai u ruajt në Principatën e Monakos.

Gjatë ceremonisë madamë Muriel Natali-Laure si përfaqësuese e Principatës së Monakos i dorëzoi këtë “Model” **Fr. Ruggero Valentini-t** president i Fondacionit “Zoja e Këshillit të Mirë” në Tiranë, i cili do ta ruajë për vitin 2026.

Për të përfaqësuar Fondacionin tonë ishin të pranishëm edhe Zëvendës-presidenti **At. Binu Peediyeckal**,

ambasador i Institutit të Mburojave të Shën Martin në Indi, **prof. Bruna Marzucchini**, ambasadore për Shqipërinë, prof. Guido Macchiarelli dhe bashkëshortja e tij. Modeli do të jetë i ekspozuar për një vit në ambientet e Universitetit.



BISEDË MËS STUDENTËVE MBI JETËN DHE SHOQËRINË

UKZKM, dimensioni njerëzor



Të martat e fundit të çdo muaji, në hapësirën e “Kopshtit të të Drejtëve” në kampusin tonë universitar, studentët e UCNSBC mbledhen për një moment diskutimi, në atë që kemi vendosur ta quajmë “E marta e studentëve”. Takimi shërben për të ndarë përvoja personale dhe për të diskutuar çështje të ndryshme që lidhen me jetën e studentëve tanë.

Takimi moderohet dhe kujdeset nga psikologja jonë, **Alketa Çoku**, e cila shprehet se kjo hapësirë do të jetë gjithmonë një oaz reflektimi mbi komunikimin që sot mungon ose që duhet inkurajuar midis të rinjve tanë. Si reagojmë ndaj njëri-tjetrit, si ndërveprojmë si studentë të të njëjtit kurs apo edhe si miq të ardhshëm? Të rinjtë sot më janë emocionalisht të angazhuar në shoqëri, dhe sa ndihmon një miqësi e mirë për të përballuar sfidat e botës dhe të modernitetit?

A është e mundur të krijohen lidhje të qëndrueshme edhe me persona me të cilët ndajmë momente specifike në kohë? Zëri i studentëve do të jetë në qendër të çdo takimi dhe përgjigjet e tyre do të ndihmojnë në sqarimin e çdo dyshimi që mund t'i shqetësojë ata. Një takim, shumë zëra, një komunitet!

NJË GJEST QË SHPËTON JETË

Nga data 11-13 nëntor 2025, që prej orëve të mëngjesit, po zhvillohet dhurimi vullnetar i gjakut në Aulën e Manekinëve të Universitetit Katolik “Zonja Jonë e Këshillit të Mirë”, në bashkëpunim me Organizatën e Dhuruesve Vullnetarë të Gjakut. Studentë dhe vullnetarë kanë dhënë ndihmën e tyre për të mbështetur qindra persona që kanë nevojë për gjak. Ky aktivitet organizohet çdo vit në kampusin e UKZKM.

Nën mbikëqyrjen e mjekëve, i gjithë procesi është monitoruar me kujdes, duke respektuar të gjithë parametrat e detyrueshëm shëndetësorë për çdo dhurues.



DONAZIONE DEL SANGUE



INOVACIONE GALENIKE DHE DITURI TRADICIONALE

Nga data 6 deri më 10 tetor, Prof. Antonio Lopalco nga Universiteti i Barit "Aldo Moro" mbajti një cikël leksionesh mbi formulimet galenike inovative të bimëve mjekësore të Ballkanit: nga njohuritë tradicionale deri te praktikat e qëndrueshme. Mobiliteti për mësimdhënie zhvillohet në kuadër të programit TNE-DESK (Developing Shared Knowledge), një iniciativë edukative transnacionale, e koordinuar nga UNIBA dhe e financuar nga Plani italian i Rimëkëmbjes dhe Rezistencës, me mbështetjen e BE-së në kuadër të programit



NextGenerationEU. Takimet nxorën në pah vlerën e galenikës si një disiplinë qendrore e Farmacisë, ku arti dhe shkencë bashkohen në përgatitjen e barnave të personalizuara, duke garantuar cilësi, siguri dhe efektivitet për shëndetin e pacientëve. Të formosh studentë të kompetentë në këtë fushë do të thotë të investosh në të ardhmen e profesionit farmaceutik dhe të promovosh një kulturë të kujdesit të vëmendshëm dhe të përgjegjshëm. Një falënderim i singertë për Prof. Lopalco për bashkëpunimin shkencor dhe mësimor, i cili ka pasuruar rrugëtimin arsimor të studentëve dhe ka forcuar lidhjen midis pedagogëve të universiteteve tona.

STUDENTËT E UKZKM BISEDONJË ME SHKRIMTARIN

Letërsia, përvoja dhe vizioni i Besnik Mustafajt



Shkrimtari **Besnik Mustafaj** u takua në Aula Magna në UKZKM me një audiencë studentore, me profesorë, mjekë të Spitalit Katolik, me Presidentin e Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë **fr. Ruggero Valentini** dhe mori prej tyre një sërë pyetjesh rreth jetës së tij të ndarë 20 vjet më parë mes politikës dhe pasionit për letërsinë. Organizimi bëri bashkë nevojën për reflektim tek të rinjtë dhe njohjen e tyre me botën letrare, përfaqësues i respektuar i të cilës është edhe Besnik Mustafaj, si dhe përballjen e vetë shkrimtarit me lexuesit e librave të tij.

Takimi u përshëndet nga Presidenti i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë **fr. Ruggero Valentini**, i cili jo vetëm po e lexon në gjuhën italiane autorin, por solli në vëmendje për publikun rëndësinë e pasurimit shpirtëror dhe njerëzor tek të rinjtë në kohët e sotme sfiduese të globalizimit dhe teknologjisë. "Vera pa kthim" romani i botuar në disa gjuhë ishte zanafilla kryesore e takimit të moderuar nga Përgjegjësjë e Bibliotekës së UKZKM **Mimoza Agastra**. Bashkëbisedimi letrar u pasurua gjatë takimit edhe me performancat e Korit të Universitetit që interpretoi Himnin Kombëtar në nder të festave të nëntorit dhe disa këngë me tekstshkrues të njohur

shqiptarë. Vetë shkrimtari e ndau bisedën me studentët dhe të ftuarit e shumtë si një udhëtim në jetën e tij ku fitoi pasionin për letërsinë dhe dëshira për të komunikuar me botën përmes prozës. Besnik Mustafaj e botoi librin e parë me poezi kur ishte ende 19 vjeç. Gjatë viteve '80 të shekullit të kaluar ai botoi edhe dy libra me poezi, dy libra me proza për fëmijë, një libër me tregime dhe një roman. Po gjatë kësaj periudhe ai shkroi edhe dy skenare për filma me metrazh të gjatë që u censuruan. Gjatë jetës ai ka fituar të gjitha çmimet letrare të vendit.

Në vitin 2019, për romanin "Dëmtuar gjatë rrugës", ai mori "Çmimin e madh" si libri më i mirë i vitit, dhënë nga Shoqata e botuesve shqiptarë në Panairin e librit të Tiranës. Në vitin 2024 romanin "Fati i marrë" u vlerësua për herë të dytë si romani më i mirë i vitit. Gjatë vitit 2025 në panairin e librit të Preshevës Besnik Mustafaj u nderua me çmimin e karrierës për veprën e tij letrare. Disa nga romanet, esetë, poezitë dhe tekstet e tij për teatër janë përkthyer në më shumë se dhjetë gjuhë madje në italisht është përkthyer romani i tij "Një sagë e vogël burgu", eseja "Shqipëria midis krimeve dhe mirazheve" dhe libri me poezi të zgjedhura "Legjenda e lindjes time". Romani i tij "Daullja prej letre" në botimin francez (Actes Sud), ka marrë çmimin "Méditerranée étranger". Romani i tij "Boshi" botuar në Francë te Albin Michel, ka qenë finalist për çmimin "Medicis étranger". Në Itali romani i tij "Një sagë e vogël burgu" ka marrë çmimin Flaiano dhe po përshtatet për teatër nga një kompani teatrore italiane. Dy romanet e tij "Vera pa kthim" dhe "Daullja prej letre" janë përshtatur edhe për skenarë filmash në Shqipëri.



LIBRAT BASHKOJNË TË RINJTË

Një takim plot entuziazëm dhe dije mes dy komuniteteve shkollore



Biblioteka e Kampusit Universitar ZKM "Fr. Paolo Ruatti" dhuroi gjatë muajit tetor një fond librash për bibliotekën e shkolles së mesme "Sinan Tafaj" si një dëshmi se kultura trashëgohet.

Një grup nxënësish dhe mësuesish të shkollës na vizituan gjatë muajit të letërsisë dhe dëshirës tonë për pasurimin e jetës në bibliotekë të rinjtë iu përgjigjën me gëzim.

Studentët e UKZKM, stafi i bibliotekës dhe ai akademik, mirëpritën nxënësit e mësueset e letërsisë së kësaj shkolle, i shoqëruan në një vizitë rreth kampusit spitalor dhe universitar ZKM dhe bashkëndanë një aktivitet të mirëfilltë letrar.

Studentët e UKZKM, stafi i bibliotekës dhe ai akademik, mirëpritën nxënësit e mësueset e letërsisë së kësaj shkolle, i shoqëruan në një vizitë rreth kampusit spitalor dhe universitar ZKM dhe bashkëndanë një aktivitet të mirëfilltë letrar.



UKZKM NË KËRKIMIN PEDIATRIK EVROPIAN



Dr. Elisa Domi, PhD, lektore dhe anëtare e Departamentit për Vlerësimin Kimiko-Toksikologjik dhe Farmakologjik të Barnave mori pjesë në "Konferencën e 11-të të Akademisë Europiane të Shoqatave Pediatrike", e cila u mbajt në Lisbonë (18-20 tetor 2025) Portugal.

Ajo prezantoi një vlerësim shkencor me titullin "Roli emergjent i vaksinimit mëmësor gjatë shtatzënisë si një strategji parandaluese ndaj Infeksionit nga Virusi Respirator Sincial në fazën neonatale". Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit Të Mirë" mbështet dhe promovon stafin e tij në kërkimin shkencor dhe në rritjen akademike.

SHKENCË, ARSIMIM DHE PROJEKTE TË PËRBASHKËTA



Nga 20 deri më 24 tetor 2025 Fakulteti i Farmacisë pati kënaqësinë të priste profesoret Alessandra Ammazalorso dhe Barbara De Filippis nga Universiteti i Chieti-Pescara, "G. d'Annunzio" si pjesë e programit të Mësimdhënies Erasmus+. Lektorët e njohura mbajtën seminare mbi shkencat farmaceutike dhe kërkimin për barna të reja shëruese duke trajtuar tema të tilla si antagonistët PPAR si agjentë premtues kundër kancerit dhe rruga nga substancat natyrore në zhvillimin e përbërjeve të reja terapeutike.

Gjatë qëndrimit të tyre profesoret morën pjesë gjithashtu në takime me stafin akademik dhe administrativ me qëllim forcimin e bashkëpunimit midis dy universiteteve dhe fillimin e përgatitjes së projekteve të përbashkëta në fushën e arsimit dhe kërkimit farmaceutik.



DIMENSION NJERËZOR DHE KULTUROR

Kujdesi për
shëndetin

Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë do të aktivizojë së shpejti një paketë kujdestare mbështetëse në fushën e shëndetit për Studentët, Punonjësit, Bashkëpunëtorët dhe Miqtë e tij.

Në bashkëpunim me një nga kompanitë e mëdha të sigurimeve në Shqipëri FZKM shpalos jo vetëm dimensionin kulturor, por edhe human të tij. Në një kartë të detajuar listohet mbështetja që do të jepet për kontrollet vjetore që sigurojnë shëndet të mirë dhe rrisin ndërgjegjësimin e të rinjve dhe bashkëpunëtorëve tanë për kujdesin që duhet të kenë ndaj dhuratës më të çmuar jetës. Paketa do të jetë e vlefshme gjatë vitit 2026 në të gjithë territorin e Shqipërisë.



NDËRGJEGJËSIMI VAZHDON EDHE NË ELBASAN

Koha për Gjirin

Në kuadër të muajit tetor, i cili i dedikohet ndërgjegjësimit dhe parandalimit të kancerit të gjirit studentët e Infermierisë të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në Elbasan u njohën me projektin kombëtar "Koha për Gjirin" (kohapergjirin.al). Projekti me drejtues shkencor **Prof. Oreste Buonomo, Prof. Denisa Esku dhe Prof. Malvina Hoxha** promovohet nga UKZKM dhe zhvillohet në bashkëpunim me Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë dhe Institutin e Shëndetit Publik.Ky projekt synon të rrisë ndërgjegjësimin duke ndihmuar në parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm të rasteve përmes farmacive pjesëmarrëse. Çdo



grua që kërkoj ndihmën e farmacistëve të përfshira në këtë projekt iu nënshtua një pyetësori shkencor që vlerësoi në mënyrë të personalizuar dhe konfidenciale nëse rezultonte me risk të lartë ndaj sëmundjes. Për **studentët e Infermierisë në Elbasan** pjesëmarrja dhe njohja me këtë nismë ishte një mundësi të vlefshme formimi profesional duke i ndihmuar ata të kuptojnë rëndësinë e parandalimit dhe të rolit aktiv që infermierët kanë në mbrojtjen e shëndetit të grave dhe në forcimin e kulturës së kujdesit parandalues në komunitet.

FORMAZIONE E PRATICA

La realtà della professione

Gjatë tre muajve **Xhesia Xhako** studente në vitin e 5-të në degën e farmacisë pranë UKZKM zhvilloi praktikën në një farmaci në qytetin e Veronës. Pas kthimit ajo tregoi për buletin tonë informativ se praktika në Itali e ndihmoi të provonte bazat teorike të marra në auditore dhe të zhvillonte aftësi komunikimi me pacientët që kërkuan ndihmën e saj. Xhesia tha se disa nga përbërjet galenike të mësuara dhe praktikuar në laboratorin e universitetit i



praktikoi konkretisht gjatë përvijës tre mujore në Verona. Falë kësaj praktike që mundësohet vetëm nga UKZKM studentët e vitit të fundit në Farmaci njihen me kërkesat e pacientëve të vërtetë dhe nisin hapat e parë në ushtrimin e profesionit të farmacistit. "Jam shumë mirënjohëse për këtë mundësi", tha Xhesia, duke falenderuar UKZKM për standardet e larta që ofroi në edukimin e saj akademik.



PAVIJONI MBI UJË

Një udhëtim poetik në arkitekturë

Në Piramidën e Tiranës u shfaq filmi dokumentar "Pavijoni mbi Ujë" nga Stefano Croci dhe Silvia Siberini, një takim mirëfill kulturor me një prezantim mirëseardhjeje nga Profesor **J.K. Mauro Pierconti**. Filmi dhe biseda më pas u harmonizuan si një udhëtim poetik në imagjinatën e arkitektit venecian Carlo Scarpa dhe lidhjes së tij me kulturën japoneze.

Përmes njohurive të filozofit japonez Ryosuke Ōhashi rrëfimi shpalosi për audiencën e pranishme pyetje dhe përgjigje mbi kuptimin e bukurisë. Reflektimi bashkoi veprat e Scarpas dhe estetikën

tradicionale japoneze. Arkitekti venecian njihet për veprat e tij dhe ndikimin e tyre në Arkitekturë. Takimi që erdhi si iniciativë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në bashkëpunim me Institutin Italian të Kulturës krijoi hapësirë modeste për eksplorimin magjepsës të veprave të Carlo Scarpa.



TË DIPLOMUARIT GATI PËR TË USHTRUAR SIPAS STANDARDEVE EVROPIANE

Ditë të paharrueshme në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" për të gjithë ne, për grupin e mësuesve të shkëlqyer që kanë ndjekur me rigorozitet dhe kanë vlerësuar meritat e studentëve tanë që diplomuan në Stomatologji dhe Protetikë Dentare dhe në Mjekësi.

Prindër, miq dhe shumë të ftuar mbushën Sallën e Madhe, duke dëgjuar solemnitetin e përgatitjes së studentëve që nga nesër do të jenë profesionistë të diplomuar sipas standardeve më të larta evropiane.



Redaktori: Sonila Agostini
Faqesja dhe grafika: Fredi Dragusha (grafplus) ZKMPress

TAKIMET E ARDHSHME



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

INCONTRO

GIORNATA INTERNAZIONALE CONTRO LA VIOLENZA SULLE DONNE

📅 25 novembre 2025

🕒 13:30

📍 Campus dell'Università Cattolica
"Nostra Signora del Buon Consiglio"
Tirana

L'iniziativa è organizzata dal Gruppo di Lavoro del Gender Equality Plan dell'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio", in collaborazione con la Pastorale Universitaria.



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO



ALUMNI REUNION

📅 18 dicembre 2025

**GIARDINO
DEI GIUSTI**

Tirana, Albania

**SCEGLI
IL GIUSTO
2026!**



**il 16 gennaio
si vota!**



FONDAZIONE
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO
Tirana
Dedicata all'educazione, dedicata alla salute



ZKM RUN (*Corsa libera*)

Ogni sabato alle 9:00 all'Università Cattolica NSBC, Tirana

